



Republika e Kosoves
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves-(SHSKUK)



Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)

Hospital and university Clinical Service of Kosova-(HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosoves-universitetski Klinicki Centar Kosova

Raport i Punës

Janar-Dhjetor 2020

Datë: 15.02.2021



Përgatitur nga:

Valbon Krasniqi- Drejtor i Përgjithshëm në SHSKUK

Liridon Gashi-Shef i sektorit për monitorim dhe vlersim të cilësisë së punës në
SHSKUK

Falënderim:

Zyra e Drejtorit të SHSKUK-së, falënderon të gjithë punëtorët e njësivë përbërse të saja, veçanërisht punëtorët mantil bardhë të cilët kanë bërë një punë shumë voluminoze dhe profesionale shëndetësore, si dhe drejtorët e njësive përbërse të SHSKUK-së të cilët kanë qenë të involvuar në punë gjatë gjithë kësaj periudhe të punës në luftë kundër pandemisë COVID-19.



Misioni:

Duke ofruar shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta ti bëjmë pacientët të shëndetshëm dhe të lumtur.

Vizioni:

Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe kënaqshmërisë së popullatës nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe sigurimit të shërbimeve cilësore shëndetësore me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive.

Përmbajtja

Hyrje.....	7
Fjala Hyrëse e Drejtorit.....	8
1. Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).....	23
2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinikë Universitare të Kosovës.....	29
3. Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme	38
4. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës	45
5.Shërbimet e ofruara nga Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës.....	46
6. Programet tjera të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.....	47
6.1. Qendra Kombëtare e Mjeksisë së Punës.....	47
6.2. Qendra Kombëtare e Telemjeksisë të Kosovës.....	48
6.3. Qendra Kombëtare Mjeksisë Sportive të Kosovës.....	49
7.Shërbimet tjera specifike të ofruara në SHSKUK.....	50
7.1. Klinika e Kardiokirurgjisë në QKUK.....	50
7.2. Shërbimet Radiologjike në SHSKUK.....	51
7.3. Shërbimet e Dializës në HSKUK.....	52
7.4. Lindjet në SHSKUK.....	52
7.5. Shërbimet e Klinikës së Onkologjisë në QKUK.....	53
Anex 1: Menaxhimi i pandemisë COVID-19 në SHSKUK.....	10




Lista e Shkurtesave

SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
MF	Ministria e Financave
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTGJ	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
QKT	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMK	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSK	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik
Psikiatrik	
BQ	Barnatorja Qëndrore

Hyrje:

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion unik, i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është e saktësuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:

- 1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
- 1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
- 1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
- 1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
- 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
- 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan;
- 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
- 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
- 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
- 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
- 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;
- 1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;(Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan;
- 1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.





Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës përmbylli sukseshëm këtë periudhë të vitit me një punë voluminoze si në aspektin profesional shëndetësor dhe atë administrativ. Në fillim të vitit është bërë planifikimi i mirëfillt i objektivave dhe aktivitetëve të SHSKUK-së, në të cilën janë paraparë shumë objektiva strategjike për realizim të qëllimeve të SHSKUK-së. Prioritet ishte furnizimi me barëra dhe material shpenzues në SHSKUK, përgaditja e planit për furnizim me pajisje mjekësore. Është vënë në funksion aparatura mjekësore për të implementuar projektin e “Strok Center”, projekt i cili ka filluar të implementohet ku edhe kemi realizuar ndërhyrjet e para dhe kemi pasur rezultate positive sa i përket shpëtimit të jetës së pacientëve. Gjatë kësaj periudhe edhe shteti ynë është duke u përballur me pandeminë globale COVID-19, për të cilën kemi bërë përgaditjet dhe ndërhyrjet e nevojshme për tu përballur me këtë infeksion. Në kuadër të SHSKUK-së, si menaxhment kemi krijuar komitetin shumë dimensional profesional për menaxhim të pandemisë, ku kemi mobilizuar të gjitha resurset tona fizike dhe ato humane për tu përballur me pandeminë. Përveq Klinikës Infektive në QKUK si menaxhment kemi krijuar kapacitete shtesë në kuadër të objekteve të cilat i kemi nën menaxhim. Janë krijuar hapsira për mjekim intenziv në objektin e ri të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive dhe Fiziatriisë, gjithashtu në kuadër të ofrimit të shërbimeve

shëndetësore për pacient me COVID, Klinika e Pulmologjisë dhe Dermatologjisë, të cilat janë krijuar si hapësira për trajtim të pacientëve me COVID-19. Klinikat të cilat janë në bllokun internistik në QKUK, gjatë vitit janë shfrytëzuar për pacientët në nevojë për trajtim të COVID-19. Gjithashtu, si menaxhment kemi obliguar që edhe shtatë Spitalet e Përgjithshme të ofrojnë shërbime për pacientët me COVID-19.

Ndër masat e marrura gjithmonë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Insitution e Shëndetit Publik të Kosovës, janë reduktuar dhe limituar ofrimet e shërbimeve shëndetësore. Kohë pas kohë janë mbyllur ambulancat specialistike, janë ndërprerë operimet elektive përpos atyre operimeve të cilat janë të natyrës urgjente. Është liruar stafi i pa nevojshëm për punë si dhe puna shëndetësore nga profesionistët organizohet me kujdestari në shumë klinika dhe shërbime.

Për-kundër kushteve të punës, njësitë përbërëse të SHSKUK-së realizuan numër të konsiderueshëm të shërbimeve shëndetësore, përfshirë operacione, shërbime diagnostike dhe vizita ambulantore.

Edhe përkundër situatës së pandemisë, në SHSKUK gjatë vitit 2020 janë ofruar **5.7** milion shërbime, 604.437 ditë të shërimit në nivel të Kosovës me gjithsej 128.298 pacientë të shtrirë. Janë realizuar 26.112 operime, 1.074.996 shërbime ambulantore, ndërsa janë ofruar edhe 2.626.623 shërbime

laboratorike për 389.936 pacientë. Numri i lindjeve ishte 19.799 të realizuara në të gjitha njësitë e ShSKUK-së, 118.549 shërbime të dializës. Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient ishte 4.7 ditë, përderisa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në ShSKUK është 42.78%.

Përqëndrimi kryesor ishte në mbarëvajtjen e shërbimeve të


domosdoshme për ofrim të shërbimeve shëndetësore, sidomos në shërbimet Emergjente dhe menaxhmin e rasteve me COVID-19, detajet tjera rreth punës në secilën nga njësitë përbërse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i gjeni në raportin e detajuar.

Valbon Krasniqi
Drejtore i Përgjithshëm në SHSKUK

1. Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në sistemin e pagave ka të regjistruar 7297 punëtorë. Mjekë specialistë janë 22% e stafit, infermier/e janë 59% dhe 19% e stafit është staf jo- mjekësor.

Të shprehur në numra, 1612 janë mjekë specialistë, 4321 të punëtorëve janë infermier/e dhe 1364 janë kuadër tjetër jomjekësor.



Figurë : Struktura kualifikuese SHSKUK



Struktura gjinore në SHSKUK		
Femra	Meshkuj	Totali
4743	2554	7297

Figure: Struktura Gjinore në SHSKUK

Figura, tregon që 35% janë meshkuj të punësuar dhe 65% e të punësuarve janë femra.

Performanca e punës në SHSKUK Janar-Dhjetor 2020

Ditë Shërimi
604437

Nr i pacientëve të Shtrirë
128298

Nr i operimeve
26112









Vizita Ambulatore
1074996

Shërbimet laboratorike
2626623

Shërbimet radiologjike
273566

Nr i lindjeve
19799

Nr i dializave
118549



Edhe përkundër situatës së pandemisë, në ShSKUK gjatë vitit 2020 janë ofruar **5.7** milion shërbime, 604.437 ditë të shërimit në nivel të Kosovës me gjithsej 128.298 pacientë të shtrirë. Janë realizuar 26.112 operime, 1.074.996 shërbime ambulantore, ndërsa janë ofruar edhe 2.626.623 shërbime laboratorike për 389.936 pacientë. Numri i lindjeve ishte 19.799 të realizuara në të gjitha njësitë e ShSKUK-së, 118.549 shërbime të dializës. Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient ishte 4.7 ditë, përdërisa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në ShSKUK është 42.78%.

Gjatë kësaj periudhe pune, në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 329 986 ditë shërimi, me 64 778 pacientë të shtrirë, nga këta pacientë të shtrirë 14.718 pacientë janë operuar. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 364.354 shërbime ambulantore për pacientë dhe 711.166 ishin shërbime të veçanta dhe diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë kryer 1.009.471 për 246.114 pacient. Shfrytëzimi i kapaciteteve në QKUK është 47.7%.

Në 7 Spitalet e Përgjithshme kishte 274.086 ditë shërimi për 63.464 pacientë të shtrirë, nga këta pacient 11.394 janë operuar. Gjithsej vizita ambulantore janë ofruar 614.094, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike ishin 1.531.527 për 137.553

pacientë, shërbime tjera apo të veçanta dhe diagnostike janë ofruar 513.199 shërbime. Lindje janë realizuar 11.013 në shtatë Spitalet e Përgjithshme. Numri i dializave të realizuar arrinë numrin e 82.645. Ndërsa mesatarja e ditore e shërimit për pacient është 4.32 ditë. Shfrytëzimi i kapaciteteve i të gjithë spitaleve të përgjithshme arrinë në 38% të shfrytëzimit të kapaciteteve.

QKSUK-ja, gjithsej ka kryer 28.414 vizita të para dhe vizita kontrolluese. Shërbime tjera të veçanta në QSKUK si shërbimet specifike të tyre janë kryer 131.093.


Në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën kishte 48.777 vizita për terapi okupuese dhe shërbime tjera, ndërsa 39.816 ishin vizita ambulantore.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë për këtë periudhë pune, regjistron 14.007 vizita ambulantore, me 85.625 (parametra) shërbime laboratorike për 6.269 pacientë dhe 27.252 shërbime të veçanta. QKMS-ja, ka kryer 14.311 shërbime specialistike. dhe QKT (telemjekësia) ka ofruar trajnime dhe telekonferenca, publikime shkencore, etj. për 7.480 personel të ndryshëm (mjek specialist, infermier, specializant dhe individ të tjerë).


2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-QKUK

Në QKUK, 37 klinika, institute dhe shërbime ofrojnë shërbime shëndetësore të ndryshme të nivelit tretësor varësisht nga specifikat e tyre.

QKUK në listën e pagave ka gjithsej 3.441 punëtorë, 2.105 punëtor i përkasin sektorit infermirisë, 780 punëtorë i përkasin sektorit të mjekëve specialistë dhe 556 punëtorë i përkasin stafit jo-mjekësor.




Figurë: Struktura kualifikuese QKUK




Performanca e njësive të QKUK-së

Ditë Shërimi	Nr i të Shtrirëve	Nr i të Operuarve	Vizita Ambulatore	Shërbime laboratorike	Nr i lindjeve	Nr i Dializave	Shërbimet radiologjike	Shërbimet Kardiokirurgjike	Sëmundjet Malinje-rastet e reja
 329986	 64778	 14718	 364354	 1009471	 8786	 35904	 132343	 3472	 1336


Lindjet




Dializa




Radiologji & Mjeksi Nukleare



Kardiologji dhe Kardiokirurgji



Sëmundjet Malinje-Rastet e reja



Në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 329 986 ditë shërimi, me 64 778 pacientë të shtrirë, nga këta pacientë të shtrirë 14.718 pacientë janë operuar. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 364.354 shërbime ambulantore për pacientë dhe 711.166 ishin shërbime të veçanta dhe diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë kryer 1.009.471 për 246.114 pacient. Shfrytëzimi i kapaciteteve në QKUK është 47.7%.

Numri i lindjeve në QKUK ishte 8.786 në total, 3.128 lindje janë kryer me operim ndërsa fëmijë të lindur janë 8.905. Nga Klinika e Nefrologjisë janë ofruar 35.904 shërbime të dializës. Shërbime radiologjike nga Klinika e Radiologjisë dhe Mjekësia Nukleare janë realizuar 132.343 shërbime të ndryshme gjithsej, CT 22.427, MRI 9.842, Mamografi statike/Mobil 1600, Ultraze 15.838, dhe për herë të parë janë realizuar 5 Strok (trombektomi). Shërbime nga shërbimi i Klinikës Nukleare në këtë periudhë pune janë realizuar 1874 Sintigrafi të ndryshme. Sëmundje malinje gjithsej si raste të reja janë paraqitur 1336 raste të reja. Ndërsa Shërbime të Klinikës së Kardiologjisë Invazive me Kardiokirurgji janë realizuar 3.472 shërbime (187 operime të ndryshme, 1157 stentime dhe 2128 koronarografi.

Shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë kësaj periudhe do të pasqyrohen si në vijim:

Nr	QKUK	Reparti	Nr i Shtretërve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Nr.të operuarve	Vizita ambulantore	Shërb. diagnostike	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera/apo te vecanta	Shfr I kapaciteteve
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	13	382	66973	14370	4897	35460	92311		12706	48.0
2	Klinika e Dermatovenerologjisë	3	36	2361	243		8869	213		6047	18.0
3	Kirurgjia Abdominale	5	69	10041	1779	1471	1810	3786		1008	39.9
4	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	1	25	4542	545	667	1424	39		521	49.8
5	Klinika e Ortopedisë dhe Traumatologjisë	4	97	7996	940	1500	14150	910		5482	22.6
6	Klinika e Kirurgjisë Torakale	1	26	5032	627	339	1775	274		1228	53.0
7	Klinika e Gastroenterologjisë	1	33	6968	882		3246	3459		5904	57.8
8	Klinika e Hematologjisë	1	28	4321	518		1945	974		14374	42.3
9	Klinika e Neonatologjisë	1	180	30761	9382		1547	915		1190	46.8
10	Klinika infektive	7	116	27176	3113		20570	1180		554	64.2
11	Klinika e Syve	1	36	7743	1415	1656	14776	1786		2301	58.9
12	Klinika e Nefrologjisë	1	18	4618	410		2901	1413		41014	70.3
13	Shërbimi i Ortoprotetikës	1					765			913	
14	Klinika e Pulmologjisë	4	68	23899	2020		20146	2657		79	96.3
15	Klinika e Kardiologjisë	3	60	15443	4733		8232	9602		525	70.5
16	Klinika e Pediatriisë	9	151	26199	3981		26571	5826		1623	47.5
17	Klinika e Endrokrinologjisë	1	36	6685	1101		7772	18495		2371	50.9
18	Klinika e Anesteziologjisë dhe Reanimacionit	3	46	11679	5308		39462			13154	69.6
19	Klinika e ORL-së	5	74	9291	971	840	12597	105		4099	34.4
20	Klinika e Neurologjisë	1	68	13621	5252		9670	4597		4758	54.9
21	Klinika e Biokimisë Mjekësore	1							1009471		
22	Shërbimi Mjekësi Nukleare	1					310	2797		1376	
23	Shërbimi Klinik Emergjent	1	19				57374				0.0
24	Klinika e Fiziatriisë	1	15	1645	103		5272	227		97480	30.0
25	Klinika e Kirurgjisë Plastike	1	20	3308	426	796	2734	258		4484	45.3
26	Klinika e Neurokirurgjisë	1	24	4204	600	397	1487	613		1626	48.0
27	Klinika e Urologjisë	1	24	2935	956	412	2440	1242		80	33.5
28	Klinika e Onkologjisë	1	14	1410	156		34256	2582		169662	27.6
29	Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologji Invazive	1	28	1767	631	187	3500	3109		1640	17.3
30	Klinika e Psikiatriisë	4	68	8178	386		8262	1846		459	32.9
31	Klinika e Radiologjisë	1						130799			



32	Klinika e Reumatologjisë	1	26	4048	677		2984	2076		418	42.7
33	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	1	37	5062	1671	807	5910	135		1085	37.5
34	Klinika Kirurgji Vaskulare	1	24	4197	976	749	3105	1304			47.9
35	Alergologjia	1	11	1031	178		2040	716		237	25.7
36	Instituti i Psikiatrisë Forenzike	3	36	6852	428		464	333		90	52.1
37	Instituti Paraklinike	1					528	15746		353	
	Total	88	1895	329986	64778	14718	364354	312325	1009471	398841	47.7

Tabela: Totali Shërbimet e QKUK-se

Klinika me më së shumti pacient të shtrirë është Klinika e Gjinekologjisë me gjithsej 14.370 pacient të shtrirë dhe me 66.973 ditë shërimi, dhe 4897 pacient të operuar, përveç shumë shërbimeve specifike të realizuara nga kjo klinikë, gjatë kësaj periudhe punë në këtë klinikë kanë janë realizuar 8.786 lindje, nga këto lindje 3.128 lindje janë realizuar me ndërhyrje cezariane, nga këto lindje kemi 8.905 fëmijë të lindur vetëm në Klinikën e KOGJ QKUK.


Klinika e Anestezionit nga gjithsej 17.846 operime të realizuara në klinikat kirurgjike në QKUK ka ofruar 13.154 anesteziione të përgjithshme.

Klinika e Neontaologjisë në QKUK, gjithsej kishte 9.382 pacient të shtrirë me gjithsej 30.761 ditë shërimi.

Klinika Abdominale ka realizuar gjithsej 1.471 operime të ndryshme, Klinika e Syve ka realizuar 1.656 operime gjithsej, në Klinikën e ORL-së, janë realizuar 840 operime.


Klinika e Ortopedisë gjithsej kishte 940 pacient të shtrirë me 7.996 ditë shërimi, në këtë klinikë janë realizuar 1500 operime.

Shfrytëzimi i kapaciteteve në Klinikat Kirurgjike



Shfrytëzimi i kapaciteteve nga klinikat e QKUK-së mesatarisht është 43%. Në klinikat kirurgjike klinika e Gjinekologjisë (KOGJ) ka 382 shtretër (66 973 ditë shërimi me 14 370 pacient të shtrirë) me shfrytëzueshmëri prej 48%. Gjatësia mesatare e shërimit për pacient në këtë klinikë është 4.6 ditë.

Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv ka shfrytëzueshmërinë në përqindje me 70% të kapaciteteve (46 shtretër).



Përqindjen më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve në klinikat internistike dhe tjera e ka Klinika e Pulmologjisë me 96% të kapaciteteve, gjatësinë mesatare të shërimit kjo klinikë e ka me 11.8 ditë shërimi për pacient (gjithsej kjo klinikë kishte të shtrirë 2020 pacient me gjithsej 23.899 ditë shërimi në 68 shtretër). Klinika e Nefrologjisë ka 70% të shfrytësimit të kapaciteteve apo 11.26 ditë mjekimi mesatarisht për një pacient. Klinika e Kardiologjisë ka 71% të shfrytëzueshmërisë të kapaciteteve apo 3.2 ditë shërimi mesatarisht për një pacient (ditë shërimi kjo klinikë ka pasur 15.443 për 4733 pacient të shtrirë brenda vitit).


Klinika Infektive në QKUK, total shfrytëzueshmërinë e shtretërve gjatë vitit 2020 e kishte 64% apo 8.73 ditë mjekimi për pacient. Gjithsej kjo klinikë kishte të shtrirë 3113 pacient me gjithsej 27.176 ditë shërimi për pacient.



3. Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme

Shtatë Spitalet e Përgjithshme në kuadër të SHSKUK-së operojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Spitalet e Përgjithshme në kuadër të SHSKUK-së kanë gjithsej 3.307 punëtorë. 704 punëtorë janë të kuadrit jo- mjekësor, 1.904 janë të kuadrit infermierisë si dhe 669 punëtorë janë mjekë specialistë.








Figurë: Struktura kualifikuese -Spitalet e Përgjithshme

Burimet njerzore sipas profesionit në Spitalet e Pergjithshme

Nr	Specializimi	Sp Prizren		Sp Peje		Sp Gjilan		Sp Vushtrri		Sp Mitrovicë		SP Gjakove		Sp Ferizaj	
		Mjek speciali st	Infermi er	Mjek specia list	Infermi er	Mjek speciali st	Infermi er	Mjek speciali st	Infermi er	Mjek speciali st	Infermi er	Mjek specia list	Infer mier	Mjek speciali st	Inferm ier
1	Infektiva	5	11	2	11	6	12	0	0	2	5	2	5	2	0
2	Kirurgjia	17	11	8	14	10	15	5	11	6	17	9	13	5	10
3	Kardiokirurgjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Kirurgjia e Femijeve	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Neurokirurgjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Urologjia	5	8	3	7	4	11	2	1	2	9	3	7	3	0
7	Torakale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Plastika	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Vaskulare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10	ORL	8	7	4	4	6	11	0	0	2	11	2	7	0	0
11	Oftalmologjia	8	7	3	4	4	3	0	0	3	9	1	4	0	0
12	Gjinekologjia	17	49	14	27	11	37	7	16	8	33	12	56	9	25
13	Neonatologjia	9	14	5	13	7	14	0	0	3	6	3	19	4	4
14	Biokimia	3	19	3	19	4	13	1	2	2	8	2	19	1	9
15	Mjekesia Nukleare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	Pediatria	14	18	7	12	7	14	7	9	8	19	10	24	8	11
17	Kardiologjia Nefrologjia	0	0	0	0	0	0	3	1	0	0	0	0	5	0
18	QKUK/hemodializa Sp	5	39	2	18	2	15	0	0	2	16	2	19	2	15
19	Gastro me Hepatologji	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0	2	1
20	Endokrina	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	3	0
21	Hematologji	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
22	Reumatologji	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	1	0
23	Neurologjia	4	11	3	10	3	15	0	0	2	9	3	14	0	0
24	Njesia koronare	8	22	3	17	3	10	0	0	0	0	4	6	0	0
25	Psikiatria	6	11	5	9	4	8	0	0	0	0	6	6	0	0
26	Forenzika	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
27	Ortopedia	7	10	5	12	3	11	1	0	6	4	7	8	4	4
28	Dermatovenerologjia Anestezioni dhe	5	2	3	1	4	2	2	0	3	2	1	7	0	0
29	mjekimi intenziv	12	27	8	41	6	24	2	14	4	25	7	16	3	9
30	Fiziatria	3	24	1	5	3	5	1	0	3	11	3	12	3	0
31	Pulmologjia	7	11	6	15	5	16	1	0	1	8	2	8	2	0
32	Emergjencia	6	25	2	26	4	32	4	13	4	23	4	18	2	30
33	Maxilla	0	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
34	Onkologjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
35	Radiologji	8	9	4	14	5	14	6	3	5	11	2	10	4	7
36	Institute	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
37	Alergologji Imunologji	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0
38	Interno	14	20	10	14	9	24	1	7	11	18	8	19	3	12
39	Barnatorja Ambulanca spec dhe	1	9	2	4	1	2	0	2	0	2	1	6	1	2
40	blloku operativ gjithsej	0	64	0	8	0	18	0	9	0	0	1	32	12	24
		172	428	109	305	111	326	48	89	79	247	95	335	79	163

Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme të Kosovës:


Performanca e Spitaleve të Përgjithshme




Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme SHSKUK								
Spitalet në Kosovë	Nr i Shtreterve	Ditë sherimi	Nr i të shtrirëve	Nr i të Operuarve	Vizita Ambulatore	Shërbime Laboratorike	Shërbime Tjera/Diagnostike	Shfryet e Kapaciteteve
Spitali Vushtrri	63	9269	2551	1030	28219	46928	20398	40.31
Spitali Gjakovë	402	58649	12289	1634	54878	331310	46931	39.97
Spitali Mitrovicë	162	26218	7831	1940	93044	84432	57300	44.34
Spitali Ferizaj	77	13893	3285	977	74312	102184	51817	49.43
Spitali Gjilan	364	39838	8747	1065	100286	154021	46955	29.98
Spitali Prizren	521	69441	17176	3222	102531	473532	164282	36.52
Spitali Pejë	387	56778	11585	1526	160824	339120	125516	40.20
Totali i Spitaleve	1976	274086	63464	11394	614094	1531527	513199	38.00

Tabela: Shërbimet e Spitaleve të përgjithshme

Tabela dhe figura e më sipërme tregon që janë gjithsej 274.086 ditë shërimi apo 10% të shërbimeve në Spitalet e Përgjithshme për 63.469 pacientë të shtrirë në Spitalet e Përgjithshme. Nga këta pacientë, 11.394 pacientë janë operuar apo 0% e shërbimeve në të gjitha spitalet të Kosovës. Gjithsej janë realizuar 614.094 vizita ambulantore apo 21% e shërbimeve, ndërsa 1.466.307 shërbime (parametra) laboratorike apo 51% (për 137.553 pacient) të total shërbimeve mjekësore. Shërbime tjera specifike dhe diagnostike ishin 513.199 apo 18% të gjithsej shërbimeve shëndetësore të ofruara në Spitalet e përgjithshme.



Shfrytëzimi i kapaciteteve në Spitalet e Përgjithshme



Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve (shtretërve) në shtatë Spitale të Përgjithshme është 38%, Spitali i Vushtrrisë ka shfrytëzueshmërinë me 40%, Spitali i Gjilanit ka përqindjen më të ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve me 30% në këtë periudhë punë. Ky zvogëlim i shfrytëzimit optimal të shtrëtërve ka rënë duke e pasur për bazë pandeminë në të cilën ndodhemi.

4. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK)

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës përbëhet nga gjithsej 177 punëtorë. 20 nga punëtorët janë kuadër jo mjekësor, 78 janë të kuadrit infermierisë si dhe 79 punëtor janë mjekë specialistë.

Në këtë institucion shëndetësor kryhen shërbime stomatologjike, të cilat do të pasqyrohen në tabelën në vijim.

QKSUK			
Vizita e pare/Vizite Kontrolluese	Aktivitete (shërbime) te Ofuara	Aktivitete jashte Prishtines	Paciente neper klinika
28414	86953	37637	6503

Tabelë: Shërbimet e ofruara QKSUK dhe krahasimet

Në QKSUK-ja ka kryer 28.414 shërbime si vizita kontrolluese dhe vizita të para, apo me 17% të pjesëmarrjes në total shërbimet e ofruara. 86.953 ishin shërbime stomatologjike të ofuara, apo të shprehur në përqindje me 54% të total shërbimeve. Aktivitete jashtë Prishtinës janë kryer 37.637, apo me 25%. Shërbime tjera në klinikë janë kryer 6.503 apo 4% të shërbimeve.





Figure : Struktura kualifikuese QKSUK




Figurë : Shërbimet e ofruara QKSUK

5. Shërbimet e ofruara nga Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor


Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës që operojnë në Republikën e Kosovës të cilat janë nën varësi të SHSKUK-së.

Në tetë njësi të shpërndara këto institucionet kanë të punësuar gjithsej 248 punëtor. 36 nga këta punëtorë janë kuadër jo mjekësor, 186 janë infermier/e dhe 26 mjekë specialistë në të gjithë Qendrat e Shëndetit Mendor të Kosovës.



Figurë: Struktura kualifikuese QSHM

Total shërbimet e ofruara nga këto njësi përbërse të SHSKUK-së, do pasqyrohen në figurën si në vijim:




Në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën ka kryer 5.284 vizita shtëpiake, 10.164 qëndrime ditore, 24.368 vizita specialistike dhe 48.777 vizita për terapi okupuese dhe shërbime tjera.

6. Programet tjera të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës bëjnë pjesë edhe këto institucione shëndetësore:

- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
- Qendra Kombëtare e Telemjekësisë
- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

Gjithsej të punësuar në këto njësi përbërse të SHSKUK-së, janë 124 punëtorë. 48 punëtorë janë të kuadrit jo- mjekësor, 48 janë infermier/e dhe 28 mjekë specialistë.



Figurë: Struktura kualifikuese e programeve tjera të SHSKUK-së

6.1. Shërbimet e ofruara nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës

Shërbimet e Qendrës Kombëtare të mjekësisë së punës Gjakove				
Reparti	Vizita Ambulatore	Vizita Diagnostike	Sherbime Larboatorike	Sherbime Tjera
12	14007	25942	85625	1310

Tabela: Raporti i punës - Mjekësia e Punës Gjakovë

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë gjatë kësaj periudhe pune, ka ofruar gjithsej 14.007 vizita ambulatorie, apo 10% të total shërbimeve të Mjekësisë së Punës. Janë ofruar 85.625 apo 66 % të shërbimeve (parametra) laboratorike për 6.269 pacientë.

Vizita/shërbime diagnostike gjatë kësaj periudhe ishin 25.942 apo 23% e shërbimeve.




Figure: Raport i Punës - Mjekësia e Punës Gjakovë

6.2. Qendra e Telemjekësisë së Kosovës

Tabela e radhës do pasqyrojë vizitat që janë bërë në Qendrën e Telemjekësisë së Kosovës:




Figure: Numri i vizitave ne QTK

Gjatë kësaj periudhe pune në Qendrën Kombëtare të telemjekësisë së Kosovës ishin 5.187 vizita në bibliotekën elektronike. Vizitorët më të shpeshtë ishin Studentët që vizituan bibliotekën elektronike të cilët vizituan 3.446 herë, mjekët specialist me 1.740 vizita, dhe 1 vizitor të tjerë.

6.3. Qendra Kombëtare e Mjeksisë Sportive

Qendra Kombëtare e Mjeksisë Sportive e cila është pjesë përbërëse e Shërbimit Spitalor Klink Universitar të Kosovës, kryen këto lloj shërbimesh:

- Vizita specialistike.
- Terapi fizikale.
- Vizita sistematike për sportistë.

Shërbimet e kryera nga QKMS, pasqyrohen në tabelat në vijim:

Kontrollat mjekësore sistematike për sportist		
Kategoritë	Nr. i sportistave	%
FUTBOLL	12124	88%
Volejbol	9	0%
Autoklubet	18	0%
KARATE	9	0%
KIK-BOX		0%
HENDBOLL	661	5%
TENIS	1	0%
XHUDO	16	0%
box	26	0%
Individual dhe studenta	322	2%
Refer	503	4%
Gjimnastike		0%
Atletike	31	0%
Not	11	0%
Pingpong	70	1%
Basketboll	24	0%
Totali	13825	

Tabela: Kontrollat mjekësore sistematike për sportistë


Mjekësia Sportive	
Vizita specialistike	198
Terapi Fizikale	288
Total	486

QKMS, ka kryer 198 vizita specialistike si dhe 288 terapi fizikale gjatë kësaj periudhe pune të vitit. Në këtë periudhë kjo njësi ka kryer 13.825 vizita sistematike për sportistë, 88% e sportistëve apo 12.124 janë të kategorisë sportive futbollist, 5% apo 661 të vizitave sistematike janë të kategorisë hendboll.



7. Shërbime tjera te ofruara në SHSKUK

7.1. Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive-QKUK



Gjatë kësaj periudhe pune në klinikën e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive në QKUK janë kryer 187 operime të ndryshme Kardiokirurgjike. Ndërsa në pjesën e Kardiologjisë Invazive në QKUK janë realizuar 1157 Stenta dhe 2128 Kooronarografi.

7.2. Shërbimet Radiologjike në SHSKUK

Në nivel vendi, janë realizuar gjithsej 35.265 CT, 51.024 ultrazë, 172.509 radiografi, 9.842 MRI, 1600 Mamografi.

Shërbimet Radiologjike në SHSKUK							
	Ct	MRI	Ultrazë	Radiografi	Angio DSA	Mamografi	Shërbime tjera Radiologjike
Spitali Vushtrri	0		1565	4107			73
Spitali Gjakovë	1455		6302	12505			485
Spitali Mitrovicë	2719		5577	12275			10
Spitali Ferizaj			3577	7052			
Spitali Gjilan	1363		846	7881			
Spitali Prizren	3817		8288	22082			
Spitali Pejë	3484		9031	22264			1461
QKUK	22427	9842	15838	80730	32	1600	330
QKMP				3613			935
Gjithsej	35265	9842	51024	172509	32	1600	3294

Tabela: Shërbimet Radiologjike SHSKUK-

Spitalet e Përgjithshme kanë kryer një numër të konsiderueshme të shërbimeve radiologjike, Spitali i Pejës ka kryer 3.484 CT, 9.031 ultrazë, 22.264 radiografi.

Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka realizuar 3.817 CT, 8.288 shërbime të ultrazërit, dhe 22.082 shërbime të radiografisë.

Nga raporti i punës së Klinikës së Radiologjisë QKUK, rezulton se janë kryer 80.730 radiografi, shërbimet me ultrazë gjithsej 15.838. Janë kryer 22.427 tomografi të kompjuterizuara (CT), 9.842 Rezonanca Magnetike (MRI), 1600 mamografi statike dhe mobile si dhe për herë të parë janë ofruar 5 Strok (trombektomi).



7.3. Realizimi i shërbimit të Dializës në SHSKUK

Dializa		
Institucioni	Numri i dializave	%
Spitali Vushtrri		0%
Spitali Gjakovë	10683	9%
Spitali Mitrovicë	10581	9%
Spitali Ferizaj	10435	9%
Spitali Gjilan	7340	6%
Spitali Prizren	30095	25%
Spitali Pejë	13511	11%
QKUK	35904	30%
Gjithsej	118549	

Tabela: Numri i dializave SHSKUK -

Gjatë kësaj periudhe pune të punës në SHSKUK, janë realizuar gjithsej 118.549 shërbime të dializës. Gjatë kësaj periudhe në QKUK janë kryer 35.904 dializa apo 30% e gjithsej dializave. Spitali i Prizrenit ka realizuar 30.095 dializa apo 25% e totalit.

7.4. Lindjet në SHSKUK

Gjinekologjia			
Institucioni	Numri i lindjeve	Numri i lindjeve me operim	Numri i fëmijëve të lindur
Spitali Vushtrri	275	101	275
Spitali Gjakovë	1748	594	1766
Spitali Mitrovicë	1598	578	1610
Spitali Ferizaj	1278	247	1326
Spitali Gjilan	1399	428	1449
Spitali Prizren	3021	947	3053
Spitali Pejë	1694	653	1710
QKUK	8786	3128	8905
Gjithsej	19799	6676	20094





Tabela: Numri i lindjeve SHSKUK

Total numri i lindjeve në këtë periudhë është 19.799 nga këto lindje 6.676 lindje janë kryer me operim, ndërsa numri i fëmijëve të lindur është 20.094. Të shprehur në përqindje 66% e lindjeve janë kryer pa operim ndërsa 34% e rasteve janë kryer me operim.

7.5. Shërbimet e Klinikës së Onkologjisë QKUK

Kjo klinikë gjatë kësaj periudhe ka ofruar shërbime për të gjithë pacientët e Kosovës. Incidenca e sëmundjeve malinje rastet e reja shfaqen në figurën e më poshtme:



Gjithsej numri i rasteve të reja të prekur me sëmundje malinje në këtë vitë janë shënuar 1336. Sëmundjet malinje rastet e reja janë paraqitur në figurën e mësipërme, më së shumti raste janë paraqitur në pjesën Urogjenital/Gjinekologjik me 321 raste dhe në pjesën e Gjirit me 332 raste të reja, 197 raste në Koke-qafe, 313 raste në Gastrointestinal dhe 173 raste në Mushkëri.



ANEX 1: Menaxhimi i pandemisë COVID-19 në SHSKUK

Problemet dhe Sfidat

Problemet përbrenda organizatës buxhetore SHSKUK, janë probleme të cilat janë krijuar kohë paskohë (ndërvite) të cilat janë të akumuluar dhe si të tilla tani janë gjatë periudhës së pandemisë janë shfaqur si anomali përbrenda SHSKUK-së.

Problemet mund të kategorizohen në dy, ato të brendshme dhe problemet nga jashtë:

Problemet fundamentale të brendshme

Nr	Problemi	Koment
1	Oksigjeni	Furnizimi me bombola të oksigjenit, në mungesë të sistemit të oksigjenimit qendror.
2	Burimet njerzore	Mungesa e infermierëve dhe mjekëve specialist për fusha të caktuara
3	Numri i limituar i shtretërve	Mungojnë shtrërit me kyqe qendrore të furnizimit me Oksigjen nëpër klnika të QKUK-së, dhe Spitale të Përgjithshme
4	Furnizimi me barna dhe material shpenzues	Anomalitë dhe burokracitë në prokurim në kohë sa më të shpejtë për produkte medicinale. Si dhe gjendjes emergjente botërore shëndetësore në furnizim me produkte medicinale.
5	Infrastruktura e Objekteve	Vështirësitë në krijimin e hapësirave adekuatë për trajtimin e pacientëve COVID

Problemet fundamentale të jashtme

Nr	Problemi	Koment
1	Bllokadat nga levizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve	Bllokadat botërore në lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve kanë ndikuar të kemi kufizime në furnizime me mallra të caktuara.
2	Buxheti	Vonesa në miratim të buxhetit të Republikës së Kosovës nga Parlamenti i Republikës së Kosovës si dhe urdhëresat Qeveritare për ndalim të shpenzimeve të kategorive ekonomike Investime Kapitale, na kanë pamundësuar zhvillimin e aktiviteteve të parapara dhe të domosdoshme për punë.
3	Rekrutimi i personelit	Me hyrjen në fuqi të ligjit për shërbyesit publik, dhe mos miratimin e rregullores për rekrutim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, na ka pamundësuar që të zhvillojmë aktivitete të rekrutimit për personel të nevojshëm në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së. Deri në muajin Nëntor të vitit 2020 nuk ishte e mundur të shpallet as një konkurs publik

Vendimet e ndërmarrura për menaxhimt të pandemisë COVID-19 në njësitë përbërëse të ShSKUK

- ✓ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), në muajin shkurt ka filluar përgatitjet për ballafaqimin me rastet e dyshuara dhe konfirmuara me Covid-19, edhe pse zyrtarisht nuk kishte ende raste të dyshuara dhe konfirmuara. Për këtë, është formuar Komiteti në nivel të ShSKUK-së, i cili është marrë me menaxhimin e situatës së përgjithshme në klinikat e QKUK-së, por edhe në spitalet e përgjithshme.
- ✓ Me datë 8 shkurt janë hapur ambulancat Covid, në kuadër të Klinikës Infektive, edhe pse ende nuk kishte raste të dyshuara dhe konfirmuara me COVID.
- ✓ Me datë 10 shkurt në këtë klinikë paraqitet rasti i parë i dyshuar, i cili regjistrohet si rasti i parë i dyshuar për COVID në Kosovë, e që më pas analizave nga IKSHPK, rezulton negativ.
- ✓ Rastet e para me diagnozë klinike për COVID 19 janë spitalizuar në Klinikën Infektive me datë 12 mars 2020 dhe janë konfirmuar në Laboratorin e Mikrobiologjisë IKSHPK ditën e nesërme me datë 13 mars 2020. **Pas mbushjes së kapaciteteve me shtretër, me rekomandim të Komitetit të ShSKUK-së, fillon zgjerimi me hapësira të reja.**
- ✓ Me 12 Mars, merret vendim për zgjerim të kapaciteteve për intensive qendrore në hapësirat e objektit të Mjekësisë Sportive, ku rasti i parë spitalizohet me datës 23 qershor 2020.
- ✓ Zgjerimi i kapaciteteve ka vazhduar edhe me hapësirat e tjera, me 17 Mars, është vendosur që të caktohet edhe Klinika e Pulmologjisë për pranimin e pacientëve, fillimisht atyre të dyshuar për COVID, e pastaj edhe pacientëve të konfirmuar. Pas mbushjes së kapaciteteve në këtë klinikë, Komiteti i ShSKUK-së, ka vendosur të zgjerojë edhe më tej hapësirat, duke liruar edhe Klinikën e Dermatologjisë për vendosjen e pacientëve.
- ✓ Me 27 Mars 2020, me rekomandim të Komitetit, caktohet një Repart në Klinikën e Pediatriisë për trajtim të fëmijëve të dyshuar dhe konfirmuar me COVID. Me mbushjen edhe të këtyre hapësirave, Komiteti me datë 8 korrik 2020, ka vendosur për lirim të hapësirave, pra një kati në Klinikën e Neurologjisë, i cili repart ka shërbyer për spitalizim të rasteve të dyshuara me COVID. Rastet e para u pranuan me 14 korrik. Më pas, po i njëjti Komitet, ka vendosur që të lirojnë hapësirat e Repartit të Operativës në Gjinekologji, ku po ashtu, ishin vendosur pacientët e dyshuar.
- ✓ Trajtimi i pacientëve të dyshuar dhe konfirmuar me Covid-19, është bërë edhe në spitalet e përgjithshme. Me datë 13 Korrik 2020, Komiteti i ShSKUK-së, ka vendosur që Spitali i Përgjithshëm i Vushtrrisë, të shndërrohet në spital Covid, në të cilin do të trajtohen pacientët nga rajoni i Mitrovicës, pra Vushtrria, Mitrovica dhe Skenderaj.
- ✓ Me 31 gusht Klinika e Neurologjisë dhe Reparti i Operativës në Gjinekologji lirohen nga pranimi i rasteve të dyshuara dhe i kthehen punës normale.
- ✓ Me 4 shtator është bërë zhvendosja e disa pacientëve nga njësia intensive e Mjekësisë Sportive për në Mjekimin Intensiv Qendror COVID.
- ✓ Nga data 21 Shtator është bërë liri i Spitalit të Vushtrrisë nga hapësirat COVID dhe Spitali i është kthyer ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët.
- ✓ Aktualisht shërbimet Covid, ofrohen në Klinikën Infektive, Klinikën e Pulmologjisë,



Mjekimin Intensiv COVID, Klinika e Neurologjisë, Spitalin e Prizrenit, Pejës Gjilanit dhe Gjakovës.

- ✓ Nga 28 shtatori ka filluar ofrimi i shërbimeve ambulatorë në gjithë ShSKUK dhe po ashtu programi elektiv i ndërhyrjeve kirurgjike, por përseri pas vendimeve qeveritare dhe shtimit të numrit të pacientëve me COVID-19 është ndërprerë shërbimi ambulator i rregullt si dhe janë ndërprerë operimet elektive.
- ✓ Në muajin Nëntor është bërë përseëri riorganizim të hapësirave të brendshme si nevojë imediate për të përfituar hapësira në klinika, ku ka oksigjen qendror me qëllim të kursimit të shpenzimit të bombolave të oksigjen. Kërkesat për furnizim me bombola të oksigjenit janë në rritje jo vetëm në vendin tonë, por edhe vendet tjera dhe kompanitë që kanë pasur kontratë nuk kanë arritur të furnizojnë sipas kërkesave.
- ✓ Klinika e Nefrologjisë, Reumatologjisë, Gastroenterologjisë dhe Hematologjisë është transferuar në hapësira tjera, me qëllim të lirimit të hapësirave që janë me sistem të oksigjenit qendror. Kemi përfituar 72 vende me kyçe në sistem qendror oksigjenit, janë afërsisht 100 bombola oksigjeni të kursyera brenda 24-orëve.
- ✓ Përmes komisionit për riorganizim të stafit, është përpiluar orari i gjendjes së gatishmërisë për krejt stafin në QKUK dhe ShSKUK, përfshirë krejt klinikat internistike- kirurgjike. Në këtë përfshihet inkuadrimi i mjekëve dhe infermierëve. Obligohen të jenë në gatishmëri 24 orë në të gjitha njësitë.
- ✓ Janë pezulluar të gjitha pushimet vjetore të stafit mjekësor, mjekë dhe infermierë, e po ashtu edhe stafit administrativ.
- ✓ Është formuar një komision për pushime mjekësore, ku do të rishikohen të gjitha kërkesat për pushime mjekësore. Sipas manualit të MSH-së, lirohen vetëm personat mbi moshën 60 vjeçare me probleme kronike shëndetësore.
- ✓ Janë obliguar shërbimet përkatëse që sa më shpejt të funksionalizojnë objektin e Mjekësisë Sportive me 100 vende të tjera për të shtrirë rrjetin.
- ✓ Ka filluar procedura urgjente për shtrirje të rrjetit të oksigjenit në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme. Shumë shpejt do të kemi projektet në detaje dhe me urgjencë do të fillojë shtrirja e rrjetit qendror dhe kalimi në furnizim me oksigjen të lëngshëm.
- ✓ Spitali i Prizrenit, meqë ka tankun për furnizim me oksigjen të lëngshëm, të zgjerojë kapacitetet edhe në reparte tjera për COVID, për të dalë në ndihmë komunave nga rajoni i Dukagjinit. Ky spital ka ndihmuar me furnizim edhe spitalet e përgjithshme.
- ✓ Janë proceduar për blerje një sasi e konsiderueshme e barnave dhe produkteve mjekësore që janë të domosdoshme për trajtim të COVID-19. Është urdhëruar Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv të përgatisin hapësira të mjekimit gjysmë intensiv në kirurgji, për të shërbyer për pacientët me politraumë.
- ✓ Është urdhëruar që të gjithë pacientët që janë nga regjionet e që janë në Mjekimin Intensiv-politraumë në QKUK, të transferohen në Spitalet e Përgjithshme.
- ✓ Po planifikohet një strategji për sallat operative. Për shkak të situatës, do të trajtohen vetëm rastet urgjente, por edhe rastet, të cilat mund të pësojnë ndryshim të shpejtë, pra në rastin ku

brenda pak ditësh rrezikohet jeta e pacientit.

- ✓ Të gjithë mjekët kirurgë, nëse kërkohet, do të angazhohen nëpër klinikat COVID.
- ✓ Janë nënshkruar me qindra vendime të ndryshme, kontrata të mjekëve dhe infermierëve të angazhuar së fundmi nga Ministria e Shëndetësisë.

Menaxhimi dhe sfidat me burimet njerzore

Gjatë kësaj periudhe punë të vitit 2020, si ndër sfidat kryesore ishte edhe menaxhimi dhe organizimi i burimeve njerzore në njësitë përbërëse të SHSKUK-së.


Janë marrë shumë vendime rreth riorganizimit të burimeve njerzore dhe hapësirave vepruese në të cilat është dashur të ofrohet shërbime shëndetësore. Shërbimet urgjente apo rastet e nxehta nuk janë ndërprere as një ditë nga të gjitha shërbimet të cilat ofrojnë njësitë nën kuadër të SHSKUK-së.

Janë ndërprerë operimet dhe shërbimet elektive, të cilat janë konsideruar të tilla nga profesionistët shëndetësor.


Gjendja aktuale e organizimit të punës në SHSKUK është si në tabelën në vijim:

	QKUK	SPITALET	GJITHSEJ
MJEK	155	450	605
INFERMIER	346	734	1080
STAF MBESHTETES	54	161	215
MJEK NE SPECIALIZIM	31	20	51
GJITHSEJ	586	1365	1951

Stafi i angazhuar sipas njësive



Angazhimi i personelit sipas profesionit



Shtatë Spitalet e Përgjithshme gjithsej direkt i kanë të angazhuar 1951 apo 70% punëtor të ndryshëm në ofrim të shërbimeve direkt që lidhen me trajtim të pacientëve me



COVID-19. Numri më i madhë është nga profesioni i kujdesit infermieror me gjithsej 1080 infermier të ndryshëm të angazhuar apo të shprehur në përqindje 55%. Mjek janë angazhuar gjithsej 605 në ofrim të shërbimeve shëndetësore që lidhen me trajtimin e infeksionit në të gjitha njësitë. Në këto shërbime janë të inkuadruar edhe mjek në specializim të cilët janë të angazhuar direkt nga Ministria e Shëndetësisë që në përqindje kapin vlerën e 3%.

PERSONELI I ANGAZHUAR NE QKUK PËR TRAJTIM TË PACIENTËVE ME COVID-19						
	Covid 3	Covid 4	Pulmologji	Infektive	MIQ Covid	MSH
MJEK	54	14	35	24	28	
INFERMIER	76	35	46	71	72	46
STAF MBESHTETES	12	6	8	8	6	14
MJEK NE SPECIALIZIM						31
GJITHSEJ	142	55	89	103	106	91

Nga Ministria e Shëndetësisë janë të angazhuar gjithsej 91 punëtor të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore për pacient të ndryshëm në klinikat COVID në QKUK.

PERSONELI I ANGAZHUAR NE SPITALE PËR TRAJTIM TË PACIENTËVE ME COVID-19								
	Sp Prizren	Sp Gjakove	SP Peje	Sp Gjilan	Sp Vushtrri	Sp Mitrovicë	Sp Ferizaj	MSH
MJEK	123	57	61	68	13	30	98	
INFERMIER	219	85	142	160	42	54	32	
STAF MBESHTETES	30	16	28	26	10	14	13	24
MJEK NE SPECIALIZIM								20
GJITHSEJ	372	158	231	254	65	98	143	44


Nga Ministria e Shëndetësisë janë të angazhuar gjithsej 44 punëtor të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore për pacient të ndryshëm në klinikat COVID në Spitalet e Përgjithshme.

Si sfidë shumë e madhë e manaxhimit të burimeve njerzore është edhe infektimi i stafit tonë, figura e mëposhtme tregon raportin e personelit të SHSKUK-së të infektuar sipas njësive:


Infektimi i stafit me COVID-19 në ShSKUK (2020)

Numri i stafit të infektuar	Numri i ri infektimëve	Vetizolim	Nr i punëtorëve të shëruar	Nr i vdekjeve	Meshkuj të infektuar	Femra të infektuar
2959	48	947	2199	12	883	1712


Stafi i infektuar sipas njësive




% e stafit të Infektuar sipas njësive






PERQINDJA E STAFIT TE INFEKTUAR SIPAS NJESIVE




Përqindja e stafit të infektuar sipas profesionit dhe njësive



Stafi i infektuar me COVID-19 në ShSKUK



Numri i punëtorëve të vdekur sipas profesionit dhe gjinisë-2020



Vdekjet sipas gjinisë në ShSKUK




Figura e mësipërme tregon që gjithsej në vitin 2020 janë infektuar 2595 punëtor shëndetësor, të shprehur në përqindje 57% apo 1.479 e stafit janë Infermier, 28% apo 720 e stafit janë mjek specialist dhe 15% apo 396 e personelit janë staf jo shëndetësor.

Të shprehur në përqindje 62% apo 1414 e punëtorët është nga QKUK, 31% e personelit apo 707 punëtor janë të infektuar nga 7 Spitalet e Përgjithshme. 2% apo 57 punëtor janë nga 8 Qendrat e Shëndetit Mendor të Kosovës dhe 5% apo 103 punëtor janë nga njësitë tjera organizative të ShSKUK.

Të shprehur në përqindje gjithsej 37% e stafit është i infektuar (44% e stafit mjek specialist, 35% infermier dhe 34% jo shëndetësor). QKUK ka infektimet më të mëdha me COVID-19 me gjithsej 50% të stafit (58% e stafit mjek specialist, 47% e stafit infermieror, dhe 53% e stafit jo medicinal). Spitalet e përgjithshme në përqindje numrin e stafit të infektuar e kanë me 23% gjithsej (27% mjek specialist, 22% Infermier dhe 21% e stafit jo shëndetësor).

Infektimet sipas gjinisë mund të komentohen kështu: Gjithsej mjeshkuj janë infektuar 883 apo 34% dhe femra 1712 apo 66%.

Personeli i vdekur gjithsej është 12: mjek specialist janë 6 punëtor, 3 infermier dhe 3 punëtor të personelit jo shëndetësor. 10 apo 83% e stafit i përket gjinisë mashkullore dhe 2 apo 17% punëtor janë nga gjinia femërore.



Menaxhimi dhe kapacitet fizike në SHSKUK

Si sfidë shumë e madhe në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së është edhe menaxhimi me kapacitetet fizike, në të cilën përfshihen hapësirat operuese, numri i shtretërve, furnizimi i rregullt me oksigjen dhe aparatura mjekësore e limituar në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së.

Janë rioranizuar pothuajse të gjitha hapësirat fizike të klinikave kohë pas kohe, kjo metodë është ndryshuar sipas nevojave dhe rritjes së numrit të infektuarve të cilët kanë kërkuar shërbime shëndetësore. Në valën e dytë kishim rreht

Numri i shtretërve të krijuar për trajtim të pacientëve me COVID-19 në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së:

		QKUK	Sp Prizren	Sp Gjakove	SP Peje	Sp Gjilan	Sp Vushtrri	Sp Mitrovica	Sp Ferizaj	QKUK	7 Spitalet	Gjithsej
Nr i shtreterve	Covid 3	114										
	Covid 4	101										
	Pulmologji	88										
	Infektive	120										
	MIQ Covid	22										
	Gjithsej	445	283	135	166	130	28	51	70	445	863	1308

Për të trajtuar të gjithë pacientët në nevoj janë adaptuar hapësira të ndryshme me gjithsej 1308 shtretër. Në Spitalet e Përgjithshme janë adoptuar ekluzivisht 863 shtretër për këtë sëmundje ndërsa në QKUK janë adaptuar 445 shtretër.

Furnizimi me Oksigjen:

Si kërkesë shumë e madhe për trajtim të kësaj sëmundje ishte furnizimi me Oksigjen, duke i ditur kapacitetet tona, menaxhmenti i SHSKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka rritur kapacitetet me Oksigjen. Aktualisht, janë nënshkruar 2 kontrata për furnizim me Oksigjen dhe Instaluar tanke dhe kemi procedura para përfundimit për furnizim me tanke të rezervuareve me Oksigjen.

Tabela e mëposhtme tregon shtimin e kapaciteteve me rezervuar dhe bombola të oksigjenit, të cilat e kanë përmirësuar gjendjen me furnizim me Oksigjen.

OKSIGJEN	NJESIA	QKU	PRIZRE	GJILA	GJAKOV	PEJ	VUSHTR	MITROVI	PODUJE	GJITHS
		K	N	N	E	E	RI	CE	VE	EJ
PARA PANDEMISE	Tank (ton)	15								15
GJATE PANDEMIES	Tank (ton)	15	10							25
NE PROCES	Tank (ton)	10		10	10	10	5	5	5	55
GJITHSEJ		40	10	10	10	10	5	5	5	95

BOMBOLA	QKUK	PRIZREN	GJILAN	GJAKOVE	PEJE	VUSHTRRI	MITROVICE	FERIZAJ	GJITHSEJ
FURNIZIME GJATE PANDEMIES ME BOMBOLA	300	125	100	100	100	95	90	90	1000

Pas sigurimit të tankeve për rezervuar të Oksigjenit, kapacitetet e SHSKUK-së, nga 15 tonë sa kishin para pandemisë, është rritur me 25-ton shtese gjatë pandemisë, dhe në proces i kemi blerjen dhe instalimin e tankeve me 55 ton, që gjithsej arrijnë kapacitetet e 75 tonve. Gjithashtu, është bërë furnizimi për të gjitha njësitet përbërëse të SHSKUK-së me 1000 bombola shtesë të oksigjenit në të gjitha njësitet përbërëse të SHSKUK-së.


Furnizimet me pajisje mjekësore:

Në njësitet përbërëse të SHSKUK-së nga buxheti vetanak është furnizuar me aparaturë mjekësore të ndryshme, ndërsa një vlerë shumë e madhe është dhënë nga donator të ndryshëm dhe shumë të nderuar:


Figura e mëposhtme tregon edhe donacionet të përfituara për njësi të ndryshme të SHSKUK-së:

Në vitin 2020 njësitet përbërëse të SHSKUK-së, kanë përfituar donacione të ndryshme në vlerë financiare prej 9.5 milion euro. Barna dhe material shpenzues është përfituar 5.1 milion euro dhe 2.6 milion euro material mbrojtës, aparatur dhe material shpenzues kundër COVID.

Ndërsa Në pajisje mjekësore, pjesë dhe servisim donacione të ndryshme është përfituar 1.7 milion euro donacione në të gjitha njësitet përbërëse të SHSKUK-së.




Përveq donacioneve dhe donatërëve shumë të respektuar, SHSKUK në bashkëpunim me MSH, ka blerë aparaturë mjekësore për të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së;



Përkundër buxhetit të limituar dhe sfidave buxhetore të paraqitura në fillim të vitit me pandeminë COVID-19, Ministria e Shëndetësisë, njësitë përbërëse të SHSKUK-së, i ka furnizuar me aparaturë mjekësore në vlerë financiare prej 1 milion euro,

ndërsa SHSKUK ka arritur të furnizohet me aparaturë mjekësore në vlerë financiare prej 880 mijë euro. Me buxhet të Republikës së Kosovës kemi arritur të furnizojmë me pajisje mjekësore njësitë përbërëse të SHSKUK-së me vlerë financiare prej 1.9 milion euro.

TRAJTIMI I PACIENTEVE ME COVID 19 NE SHSKUK (12.03-31.12.2020)



Numri i pacientëve të shtrirë për trajtim nga dita në ditë ka shënuar rritje dhe zbritje të ndryshme, lakorja me ngjyrë të kaltër tregon numrin e pacientëve të hospitalizuar sipas ditëve në SHSKUK. Në “fazën I” të pandemisë numrin më të lartë të hospitalizuarve njësitë përbërëse të SHSKUK arritën në muajin Prill me 76 raste, ndërsa tani në “Fazën II” kemi numër prej 645 të pacientëve të hospitalizuar, më datë 30.11.2020 që e paraqet numrin më të lartë të hospitalizuarve gjatë kësaj pandemie është 1010 pacient në të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK, më datë 31.12.2020 kemi 486 pacient të shtrirë. Ndërsa lakorja me ngjyrë portokalli tregon numrin e pacientëve të cilët janë trajtuar me oksigjen, në Prill numrin më të lartë e kishim 17 pacient të cilit ishin të shtrirë në Klinikën Infektive të QKUK, në Gusht kishim 419 pacient të cilët janë trajtuar me Oksigjen ndësa më datë 30.11.2020 kemi 728 pacient të cilët janë trajtuar me Oksigjen, më datë 31.12.2020 kishim 301 pacient me O2. Numri më i lartë i pacientëve të cilët janë trajtuar me CPAP në Gusht ishte 36, ndërsa më (31.12.2020) kishim 27 pacient të cilët janë trajtuar me CPAP. Numri i pacientëve të cilët janë intubuar në Gusht ishte më i larti me 24 pacient ndërsa më datë 31.12.2020 kishim 11 pacient të intubuar.

